



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti-na

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe në bazë të nenit 35 paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-147, neni 4, pika 4, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik në sektorin Publik, si dhe Udhëzimin administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtoria për Arsim e Komunës së Vitisë shpall:

KONKURS PUBLIK

SHFMU "28 Nëntori" në Verban

- Një (1) mësues/e klasor.

SHFMU "Skënder Emërllahu" në Ramjan

- Një (1) arsimtar/e të lëndës Gjuhë Angleze, zëvendësim deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Njazi Rexhepi" Sllatinë e Epërme

- Dy (2) mësues/e klasor
- Një (1) arsimtar/e të lëndës Gjuhë Angleze, zëvendësim deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë.

SHFMU "Halil Alidema" në Pozhoran

- Një (1) arsimtar/e për lëndën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe zëvendësim deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë.
- Një (1) mësues/e klasor.

SHFMU "Nazmi Pajaziti" në Radivojc

- Një (1) arsimtar/e të lëndës Fizikë.

SHFMU "Dëshmorët e Lubishtës" në Lubishtë

- Një (1) arsimtar/e të lëndës Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.
- Një(1) mirëmbajtës/e me kohë të caktuar, deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë – Paralelja e ndarë në Podgorcë.
- Një (1) mësues/e klasor.

SHFMU "Dom Mikel Tarabulluzi" në Stubëll

- Një (1) arsimtar/e të lëndës Gjuhë Angleze me kohë të caktuar, deri në kthimin e punëtorit në vendin e punës.

SHFMU "Ndre Mjeda" Kabash

- Një (1) mësues/e klasor.
- Një(1) mësues/e klasor, zëvendësim deri të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë;

SHFMU “Safet Rexhepi” në Zhiti

- Një (1) arsimtar/e të lëndës histori.

SHMM” Kongresi i Manastirit” në Pozheran

Një (1) Profesor/esh të lëndës Fizikë, zëvendësim deri të kthehet punëtori nga pushimi mjekësor.

SHML Gjinnazi “Kuvendi i Lezhës” në Viti

- Një (1) profesor/esh të lëndës së Kimisë, zëvendësim deri të kthehet punëtori nga pushimi mjekësor.
- Një (1) punëtor teknik.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit, i cili merret në zyrën e DKA-së;
- Diploma (çertifikatën e diplomimit, jo më e vjetër se 6 muaj) e fakultetit, e vërtetuar te noteri;
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime;
- Të diplomuarit jashtë vendit, diplomat e tyre t’i nënshtrohen procesit të nostrifikimit nga MASHT-i.

Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e punëtorit teknik (mirëmbajtës), duhet t’i plotësojnë këto kushte:

- Të kenë çertifikatën e lindjes;
- Të kenë diplomën e shkollës së mesme-fillore;
- Të kenë çertifikatën e gjendjes shëndetësore;
- Të kenë çertifikatën se nuk është nën hetime.

Kandidatët të cilët konkurrojnë në pozitën mesimdhënëse, duhet të kenë përgatitjen përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të lartcekur.

Kandidatët e interesuar për aplikim, aplikacionet i marrin në web-faqen e Komunës dhe në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe i dorëzojnë në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Viti.

Dokumentet e pakompletuar dhe jashtë afatit nuk do të shqyrtohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet me datë **30.01.2019, në ora: 14:00** në lokalet e SHFMU “Dëshmorët e Vitisë” në Viti.

Viti, më 11.01.2019

**Drejtoresha për Arsim
Fatbardha Emini- Halabaku**